

20111362993

L I G J
PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TOPOGRAFISE
SË QARQEVE INTEGRALE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e topografisë së qarqeve integrale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 5/98 dhe 33/2006), pas nenit 13 shtohet nen i ri 13-a, si vijon:

"Neni 13-a

(1) Aktvendimin nga neni 13 paragrafi (4) i këtij ligji, Enti e lëshon në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkeses me dokumentacionin e nevojshëm për lëshimin e aktvendimit.

(2) Nëse Enti nuk e lëshon aktvendimin, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin e percaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, parashtruesi i kërkeses ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga kalimi i këtij afati të parashtojë kërkesë në sekretarinë e drejtorit për miratimin e aktvendimit nga drejtori.

(3) Formen dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, i përcakton drejtori.

(4) Drejtori detyrohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni në sekretarinë e drejtorit, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për përcaktimin e shkeljes së të drejtës pranohet apo refuzohet. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Entit.

(5) Me kërkesën për realizimin e së drejtës nga paragrafi (2) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës parashtron kopje të kërkesës nga neni 13 paragrafi (1) i këtij ligji.

(6) Nëse drejtori nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(7) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (6) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje inspektuese në Entin dhe të konstatojë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(8) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nga paragrafi (7) i këtij neni, pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon drejtorin, që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesen e parashtruar, përkatësisht ta pranojë ose ta refuzojë kërkesen dhe për masat e ndërmarra në afatin e njëjtë ta njoftojë inspektorin dhe t'i dorëzojë ekzemplar nga akti me të cilin është vendosur për kërkesën.

(9) Nëse drejtori nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin drejtori do të vendos për kërkesën e parashtruar, për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse drejtori nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (9) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkeses për masat e ndërmarra.

(11) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (7) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë që të paraqesë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(12) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (11) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni ose nuk ka paraqitur kallëzim në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuara në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në Entin nëse procedura është zbatuar në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragrafi (12) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një dite të punës, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(15) Në rastin nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës, do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (12) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent, në afat prej tetë ditëve të punës.

(17) Nëse drejtori nuk vendos në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(18) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(19) Akti nënligjor nga paragrafi (3) i këtij neni do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(20) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (3) i këtij neni, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Entit."

Neni 2

Kunder aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për leshimin e aktvendimit, kërkuuesi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozites nga neni 2 i këtij ligji, që do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.